



ADVANCING KOSOVO WOMEN'S
AGRIBUSINESS INCLUSION (AKWA)



**CARE International financuar nga Land Vorarlberg, me projektin
“Avancimi dhe Përfshirja e Agrobizneseve të Grave në Kosovë (AKWA)” fton
GRATË NGA ZONAT RURALE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS,**

të aplikojnë për mbështetje në

DIZAJNIN E VIZUALITETIT DHE BRENDIMIT TË BIZNESIT

Projekti do të mbështesë deri në 14 gra me grante për dizajnin e vizualitetit dhe brandingut të biznesit.

- Dizajn kreativ për brandimin e agrobiznesit dhe produkteve, duke përfshirë logon, publikime në rrjetet sociale, dizajnin e vizitkartelave të biznesit dhe stikerave.
- Shtypja e materialeve të dizajnuara për brandim, përfshirë vizitkartelave, stikerat me cilësi të lartë, tabelat promocionale dhe materialet promocionale tjera të përshtatshme.

Shuma maksimale e mbështetjes përmes granteve është 300 EURO

Kush mund të aplikojë:

Gratë e moshës 18 - 60 nga komuna e Podujevës, duke përfshirë gratë nga grupet e marginalizuara (ato të rrezikuara nga varfëria, të pafavorizuara, gra të kthyer nga vendet perëndimore, minoritete, gra nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian), të cilat janë të angazhuara ose kanë kapacitet për t'u angazhuar në aktivitete bujqësore ose agrobiznes, me plane për të tregtuar produktet e tyre dhe angazhim për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e projektit (trajnim dhe shërbime këshillimore). Prioritet do t'u jepet grave që kanë përfituar grante në përmes projektit.

Aplikimet mund të merren nga zyrat e bujqësisë në komunën e Podujevës ose të kërkohen përmes emailit në demaj@care.de.

Aplikimet e kompletuara me dokumente mbështetëse duhet të dorëzohen në vendet e mëposhtme:

- Komuna e Podujevës - Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

Aplikimet mund të dorëzohen gjithashtu edhe përmes e-mail-it në këtë adresë: demaj@care.de

Thirrja për aplikime do të jetë e hapur deri më datë 31.03.2026, ora 15:00 dhe inkurajohen aplikimet e hershme.